

Rrustem Berisha

PREZENTIMI DHE QËLLIMI I BOTIMIT TË LETËRSISË POPULLORE NË „ALBANIA”

Rëndësia dhe vlera e revistës *Albania* duhet të studjohen nga shumë aspekte që të shihet kontributi i saj në kulturën e gjithëmbarshme kombëtare. Revista u ka kontribuar, ku më pak e ku më shumë, disa dishiplinave albanistike; disa probleme shkencore dhe kulturore janë trajtuar në faqet e saj që ruajnë vlerën e tyre qoftë si fillim, qoftë edhe si vlerë me interes më të qëndrueshëm për ne. Duhet konstatuar se disa nga shkrimet rreth letërsisë popullore apo të ndonjë problemi tjetër duken si thërmia, në formë lajmesh e informatash, por megjithatë të rëndësishme, në mos për tjetër, për fillimet e përpjekjeve që të krijohet baza kulturore kombëtare.

Albania, edhe pas gjashtëdhjetë e gjashtë vjetësh të shkuara, ruan vlerën e saj dhe ka rëndësi për kulturën tonë shpirtërore dhe materiale. Programi i saj ishte mjaft i gjerë: ajo shkruan dhe kontribuon për zgjidhjen e problemeve të gjuhësisë, të historisë, të etnografisë, të kritikës, të letërsisë së shkruar dhe të letërsisë popullore. Të gjitha këto fakte i shpien më tej studimet e këtyre dishiplinave, jo vetëm duke i nxitur, por edhe duke i begatuar. Pra, shikuar në prizmen e interesimeve të përgjithshme, kjo revistë është marrë aktivisht me probleme të kohës, të cilat për shqiptarët e kishin orën e aktualitetit.

Jeta e *Albania* - s nuk është as e shkurtë, as e lehtë, kur dihet se vepërimitarinë e saj e zhvilloi jashtë atdheut dhe me bashkëpunëtorë të shpërndarë në të katër anët. T'i shtosh kësaj edhe pretendimet që të bëhet prijatë në frontet e shumta kulturore e shkencore, ngjashëm me përpjekjet e lëvizjes kombëtare shqiptare, duke u dhënë zemër krijuesve, ashtu si vepruan shumë gazeta të tjera, që „kishin për moto mbrojtjen e interesave të kombit shqiptar,”¹ mund të diktohet qartë rruga e mundimshme që bën ajo.

Në atë kohë Shqipëria ishte nën sundimin turk. Ajo ndodhej para sulmeve të mëdha fizike, politike dhe propagandistike. Shkollat dhe kulturat e huaja, si: të Turqisë, të Italisë, të Greqisë e të tjera, ushtronin ndikim në jetën e shqiptarëve në përgjithësi, duke u përpjekur të mposhtin idealin dhe përpjekjet e tyre për liri. Në atdheun e robëruar armiqve u bëhej rezistencë kryesisht me

¹ Palok Daka, *Bibliografi retrospektive e shtypit periodik shqiptar e mbi Shqipërinë e vjetërve 1848-1912*, Përparimi nr. 9, 1972, f. 805.

armë, ndërsa mërgimtarët dhe të dëbuarit nga atdheu, në qendrat e kontinenteve të ndryshme dhe të shteteve të Ballkanit, u bënë rezistencë me anë të shoqërive të ndryshme, me anë të gazetave, me krijimtari letrare e shkencore dhe me publikime të tjera politiko-propagandistike. Duke bërë fjalë për shtypin shqiptar mes viteve 1848-1912, Palok Daka konstaton: „Gjatë kësaj periudhe shtypi ynë u botua kryesisht jashtë Shqipërisë dhe pati në përgjithësi, më pak përjashtime, një tendencë, të theksuar politike, shoqërore e kulturele me drejtim përparimtar për kohën e vet: nga ana tjetër, ky shtyp karakterizohet edhe nga një veprimtari spontane dhe ku ndjehej mungesa e një udhëheqjeje të organizuar”.² Vlen të theksohet se shtypi ishte bërë trumpetë e zërave të guximshëm e shpresëdhënës në kohën e sundimit të autoriteteve turke, por kryesisht jashtë kontrollit të tyre, meqë me shekuj ishin përpjekur që kultura dhe arsimimi të mos depërtojnë në Shqipëri.

Nuk ka dyshim se komunikimi i qendrave patriotike me atdheun, për atë kohë, ka qenë mjaft i vështirësuar. Duhet konstatuar se mungonin burimet e informimit të drejtë dhe të saktë. Autorët ruheshin nga rreziqet e ndryshme me anë të anonimitetit, duke mos dhënë shënime për vendin ku ndodheshin. Kjo ka bërë që në *Albania* të zotërojnë plotësisht pseudonimet.

Një vlerësim, deridiku i denjë për këtë revistë, edhe pse mjaft i përgjithësuar, mund të konsiderohet edhe ky:

„Albania” ka qenë organi më i rëndësishëm letrar dhe kultural i kohës. . . Një meritë e madhe e „Albania-s” qe se ajo grumbulloi rreth vehtes shkrimtarë shqiptarë më të shquar të kohës dhe sidomos talentet e reja, që në shumicë debutuan në faqet e saj. Ndër ta le të përmendim F. Shirokën, L. Gurakuqin, L. Logorin, Gj. Fishtën, Sh. Gjeçovin, M. Duçin, Çajupin, F. Nolin, H. Mosin. Revista botoi vazhdimisht letërsi dhe folklor. Ajo botoi sidomos poezi, po edhe shkrime të ndryshme të prozës artistike, si përshkrime, tregime, prozë, poetike, pa harruar shkrimet e shumta publicistike. Në faqet e saj mund të themi se fillon kritika letrare, me disa recensionet dhe ndonjë artikull teorik të Konicës. Gjatë 13 viteve, „Albania” botoi disa qindra faqe me lëndë letrare të gjithëllojshme, duke dhënë kështu një kontribut të madh për zhvillimin e letërsisë së Rilindjes. Ajo lojti kështu rol për zhvillimin e shijes artistike-letrare dhe për krijimin e një shtypi letrar shqip me cilësi”.³

Albanologu Pedersen me siguri këto fakte do t'i ketë pasur parasysh kur ka shkruar për Albaninë se:

„Botimi më me rëndësi i bërë gjer më sot nga ana e Shqiptarëve, është e përkohëshmia *Albania*. S'është mundimi i parë për të themeluar një gazetë shqipe . . . Po *Albania* është pa fialë shumë më e rëndë se të tierat më parë saj, e kemi shpresë se ka për të vajtur mbarë”.⁴

Revista ka shkruar për të gjitha revistat dhe shoqëritë e kohës, që do të thotë se afirmonte, në një mënyrë, rezultatet kulturele të shqiptarëve, ashtu si bënte për rezultater e arritura në letërsi.

Albania ka botuar letërsi popullore më shumë se çdo revistë apo gazetë tjetër e kohës. Edhe ky kontribut i ka caktuar vendin në historinë e folk-

² *Aty*, f. 806.

³ *Historia e letërsisë shqipe I-II*, Prishtinë, 1968, f. 283.

⁴ *Albania* nr. 4, 1902, f. 103, 104. (Të gjitha citimet nga *Albania* i dhamë në alfabetin e sotshëm).

loristikës: „Ndër fletoret e kohës së pushtimit turk rregullisht folklor botoi (disa herë edhe në përkthim frëngjisht), revista e Faik Konicës, *Albania* Bruxelles dhe London 1897-1909, dhe, përpara saj, revista e De Radës *Flamuri i Arbërit*, Cosenza 1883-1887”.⁵

Revista botoi letërsi popullore herë më shumë e herë më pak. Mund të supozohet se revistës i ka munguar materiali folklorik. Redaksia shpesh u bën apel bashkëpunëtorëve që të mbledhin dhe të dërgojnë letërsi popullore sa më shumë. Ajo ndër intelektualët nxiste dashurinë për këtë pjesë të letërsisë, duke dhënë shembuj se si punohet në vendet e tjera dhe se me këtë pasuri shpirtërore e mendore të popullit merren shkencëtarë të njohur. Angazhimi i revistës në këtë drejtim është i qartë: ajo në ndonjë numër botonte nga gjashtë-shtatë këngë, por ndodhte që në ndonjë numër të mos kishte asnjë. Mund të supozohet se revistës i mungonte materiali folklorik, sepse selia e revistës, e cila ndodhej jashtë atdheut, nuk kishte mundësi komunikimi dhe bashkëpunimi të vazhdueshëm me të interesuarit në atdhe, të cilët kryesisht mund të vilnin folklorin nga burimi i vërtetë. Letërsinë popullore e mbledhnin edhe nga subjektet e ndryshme në mërgim, ose kur ktheheshin kohë pas kohe në atdhe. Këtë pengesë e vë në pah vetë Redaksia. Nga kjo rjedh fakti se tingujt e këngës popullore, urtia e pleqve, fantazia e përrallave, butësia e erotikës, vështirë janë prezentuar këtu në mënyrë të denjë.

Albania kishte programin, të cilin e respektoi gjithmonë. Në faqen e parë të revistës shkruante: *Vjersha. Këngë të Popullit. Gjuhësi. Histori. Shkencë. Të Reja*. Si po sihet, letërsisë popullore iu caktua vendi para shumë disiplinave të tjera. Ajo, me një përkushtim të tillë, mbeti revistë me rëndësi për historinë e letërsisë popullore dhe në këtë pikë i takon respekti asaj dhe bashkëpunëtorëve të saj. Revista, theksoi disa herë rëndësinë dhe bukurinë e kësaj letërsie, duke u orvatur t’ua bëjë të njohur edhe të huajve përmes përkthimit në gjuhën frënge. Nga kjo pikëpamje janë me rëndësi ato shënime të vogla të botuara në revistë, të shkurtra dhe të shprehura nga ata që nuk merreshin me studimin e kësaj letërsie, por që ushqenin simpati të madhe për të. ndër këto shënime ka ftesa për mbledhjen dhe botimin e letërsisë popullore, bëhet fjalë për rëndësinë e saj, ka edhe ndonjë koment që e shoqëron këngën ose ngjarjen rreth së cilës bën fjalë kënga, si dhe ndonjë vlerësim i nxitur nga entuziazmi.

Nga këto shkrime kuptojmë dëshirën e Redaksisë që të mblidhet kjo letërsi, të publikohet dhe të shijohet nga masat më të gjera, të kuptohet roli dhe rëndësia e saj gjatë shekujve, të forcohet ai rol edhe në çështjen e zgjimit kombëtar, ta shfrytëzojnë shkrimtarët për krijimtarinë e tyre, e ndër të tjera, përmes publikimit të saj në gjuhën frënge, ta njohin vlerën e saj edhe të tjerët. Pretendimi i një reviste që të përmbushë të gjitha këto synime në të mirë të shkencës së folklorit, e bën atë të nderuar në mesin e revistave shqipe. Duke e shqyrtuar çështjen e prezentimit të letërsisë popullore në *Albania*, patëm parasysh edhe qëllimet e redaksisë që t’i inkuadrojë intelektualët shqiptarë në përpjekje për zgjimin e ndjenjës kombëtare në kohën e Rilindjes.

Redaksia e *Albania*-s ka pasur arsye, meqë edhe ka ditur ta çmojë, që të mbështetet në letërsinë popullore, e cila ka vlera të justifikuar, është e

⁵ *Historia e letërsisë shqipe I-II*. Prishtinë, 1968, f. 27 (Shënimi nën fusnotën 14).

afërt me komunikimin, përjetimin, psikologjinë e masave dhe i bind ato, duke i përvetësuar më lehtë. Në këtë drejtim, mund të pohojmë se letërsia popullore në shumë ngjarje me rëndësi për popullin, është inkuadruar me sukses. Kjo letërsi, si shprehje realitetit mbrenda mundësive të krijuesit shpesh ka luajtur rolin e mobilizuesit kundër të huajit. Ky art, që me shekuj ka ushqyer shpirtin e masave ndër ne për një periudhë më të gjatë në mungesë të letërsisë së shkruar, ka zgjuar idealin për liri, ka forcuar qëndresën e përgjithshme popullore. Prandaj, në periudhën e veprimtarisë së gjithanshme që zhvillonin shqiptarët për pavarësi, kur rilindësit shkruanin me angazhim të veçantë për çështjen kombëtare, letërsia popullore, përkrah poezive të Naimit, Asdrenit, Çajupit, Gurakuqit, Mosit, Shirokës e të tjerëve, të cilët botonin në këtë revistë, luante rol të madh, sepse ishte vetë zëri i popullit, i cili nuk mund të lihej në harresë. Si i pat ndodhur shpesh popullit tonë të bënte lufta për liri e pavarësi, ky zëri i letërsisë popullore u kthehej masave të gjera për t'ua forcuar qëndresën dhe idealin gjithnjë më të fuqishëm, më të guximshëm, duke i paraqitur përherë më madhështore trimëritë e të parëve. Kështu, këngët popullore, si edhe më parë, u angazhuan aktivisht dhe u aktualizuan ashtu siç kishte ndodhur me këngët e Skënderbeut e të trimave të tjerë, të cilat me dhjetra herë e shoqëruan njeriun tonë në luftë pas vdekjes së kryetrimt. Pra, në hap me ngjarjet politike të kohës, krahas përpjekjeve të përgjithshme të lëvizjes kombëtare, letërsia popullore realizonte misionin e saj historik. Kjo detyrë nuk mund të konsiderohet si koincidence e rastit në ato çaste vendimtare, por si detyrë që ka arti për vete t'i luftojë të këqijat, të cilat i bien popullit në qafë. Mund të thuhet se ato këngë të botuara në *Albania* e ndiznin zemrën e patriotëve në luftë kundër të huajve, i afronin shqiptarët mes veti, sillnin në arenën e aktualitetit fytyra luftëtarësh në zë. Ajo edukonte masat si gjithmonë duke ua mësuar urtinë, qëndresën, shpirtgjerësinë, u mësonte atyre ta zhgulin servilitetin dhe frikën, që i huaji ishte përpjekur t'i kultivojë në atë mes gjatë sundimit pesëshkullor, duke futur edhe përçarje në mes të besimeve të ndryshme.

*I thot muslimani: „Hajde me mue,
Se e kam kohën me t'peshtue”.*
*E bajraktari e pat nigjue,
E e morën rrugën për me shkue,
Nëpër pydh e nëpër prue
Të dy shnosh i pat kalue.
O të kjosha fal Zot e Perenie
Se shumë pun të mira janë në Shqypnie!
Se ç'bes ka Shqypnija mren,
Biret muslimani për të keshten.*

*Toske e Gege me u — bashkue
Se është forc'e madhe me qinrue,
Mos te mune anemiku me na shtrure,
Se tash Pese — qin vjet kemi qinrue!⁶*

⁶ *Albania*, nr. 11, 1905, f. 211.

Po të analizohet mirë në pikëpamje të arkitekturës poetike popullore, mund të dyshojmë se kjo këngë është e përpiluar nga ndonjë vjershëtor për hir të kërkesave të lëvizjes kombëtare. Megjithatë, ne jemi të detyruar ta pranojmë si këngë popullore, sepse është botuar si e tillë e s'është edhe e vetmja. Tekefundit, i besojmë edhe këtij fakti, si fakteve të tjera që janë botuar në revistë. Lëvizja kombëtare zhvillohej në kushte më të përshtatshme mu pse vetëdija e njerëzve për pavarësi ishte shumë më e lartë, prandaj edhe efekti i një kënge të tillë, qoftë edhe e krijuar vetëm për ato rrethana, është i madh. Luftëtarët, qofshin ata me armë, qofshin ata të betejave politike, qenë kësaj radhe më të fortë, më të kalitur, dhe më të sigurtë në fitore. Një kësi mësimi e predikon vetë kënga disa vjet para pavarësisë.

Në numrat e *Albanisë*, gjatë kësaj periode, janë botuar mbi njëqind e pesëdhjetë njësi nga letërsia popullore dhe shënime rreth saj. Ky numër do të na dilte më i madh sikur t'ia shtonim edhe njësitë që janë botuar në gjuhën frënge e që kishin për qëllim t'ua prezentonin të tjerëve pasurinë shpirtërore e mendore të popullit tonë.⁷

Në *Albania* u botuan këngë historike, këngë dashurie, përralla, fjalë të urta, që titullohen me *Të thëna ose T'perfoluna t'hereshme shqyp*, legjenda që kanë të bëjnë me jetën e Skënderbeut. Nga ky numër i punimeve, mjaft i llojllojshëm, do të mundë të bëhej një vepër modeste. Megjithatë, nuk do të bëjmë fjalë për vlerën artistike të kësaj letërsie të publikuar këtu, sepse këto këngë ose variantet e tyre janë botuar në vëllimet e mëvonshme që dolën në Shqipëri apo në Kosovë. Pos qëllimit që kishte Redaksia që këtë letërsi ta inkuadrojë në zgjimin e ndjenjës kombëtare për shkak të influencës që ushtron në masa, janë me rëndësi të veçantë disa shënime të shkurta, që botohen lidhur me letërsinë popullore. Më në fund, ato janë shënime që e pasurojnë historiatin e kësaj pjesë të letërsisë, si dokumente që janë shkruar para gjashtë dekadave e gjysmë.

Në numrin e parë *Albania* boton përrallën *Lajthimi*. Nga përmbajtja e saj, Redaksia nxjerr një mësim dhe jep porosi që t'u ruhen mashtrimeve të qeverisë dhe të halldupëve. Ky theks mbi rëndësinë e letërsisë popullore në revistë është vënë për një kohë të gjatë dhe do të thotë që lexuesit të nxjerrin vetë nga botimet e tilla mësimet lidhur me rrethanat dhe situatat e krijuara. Me shënime përcillen këngët për Selman Likën, shënimet për jetën e Oso Kukës, që ilustrohen me vetë këngën për Oson, Kënga e Ulkrinit, Këngët Majit të Mitkos dhe katër këngë të tjera të këtij autori, Lufta e Krimesë etj.

Në këngët historike shfaqen motivet e luftës së shqiptarëve kundër të huajve që kanë pretendime të llojllojshme. Për kohën kur i boton revista, ato e kanë qëllimin e tyre për ngritjen e idealit kombëtar *në vetë* përmbajtjen dhe këtë funksion e kryejnë edhe në ato rrethana. Një lloj funksioni edukativ e kryejnë edhe këngët me motivin e vëllavrasjes, të cilat me komunikim të drejtëpërdrejtë do të thonin se a thua është koha të vriten shqiptarët në mes veti, apo është koha të bashkohen në luftë për pavarësi. Mund të themi se, në një mënyrë ose në një tjetër, letërsia popullore ngriste tensionin për luftën, të themi kështu, vendimtare të shqiptarëve. Na jepet mundësia për konkluzione të

⁷ Në disa numra të *Albanisë* u botuan materiale të letërsisë popullore në gjuhën frënge, me titujt *Milo et Haidhée dhe Documents sur le folklore Albanais*.

tilla, sepse të gjitha këto aktivitete të A l b a n i a -s dhe të shtypit tjetër, zhvilloheshin në prak të pavarësisë kombëtare. Efekt të madh mobilizues kanë ushtruar këngët për Skënderbeun, për Ali Pashë Tepelenën, ndërsa përballë tyre qëndronin figurat e Hafiz Pashës, Hajredin Pashës, të vezirëve të tjerë që me aksionet e tyre ushtarake kishin dështuar plotësisht në Shqipëri, ishin ndarë keq. Këngët e tilla, që hiperbolizonin veprimet e trimave tanë, duke i paraqitur të pamposhtura kullat, kalatë, grykat, që nuk u bën gjë as topi as kumbaraja, ngritnin moralin e luftëtarëve, forconin dashurinë për vendin e tyre, forconin ndjenjën e bashkimit.

Redaksia e revistës ka sinjalizuar për tryezat qëllimkëqija të shteteve të mëdha. Duke u bazuar në këto fakte, mund të supozojmë se njësoj si këta artistkuj gazetarie, ashtu edhe letërsia popullore vënin në shënjestër të njëjtën pikë, armikun shekullor dhe armiqtë e tjerë përkrah tij.

Duhet të themi se edhe fjalët e urta, të cilat jepen me shpjegime, kanë të njëjtin qëllim, paraqesin mendimin filozofik të popullit në mënyrë të dendur dhe të bukur, shprehjen lakonike të komunikimit, ku zgjuarësia përqëndrohet në atë që me pak fjalë të shprehet përvoja e gjatë me përfundim të prerë. Fjalët e urta, që botohen në shumë numra të revistës, kanë atë elegancën e tyre, që njeriu mund t'i shtjerë në punë gjithmonë me të njëjtin intensitet. Në anën tjetër, përmbajtja e disa prej tyre përputhet mjaft me aktualitetin shoqëror-politik të kohës. Ja disa sosh, kuptohet të nxjerra nga numrat e ndryshëm të revistës:

Trimi i mir me shok shumë.

Pushka e trimit e tryeza e xhumertit nuk priten.

Ma mir Sokol ni vjet se Hut ni qin.

Ma mir flak e kuqe se fut e zez.

Ma shumë men se gja.

Natyrisht se e pamë të rrugës të mos japim shpjegimet që të mos e lëndojmë pa nevojë urtinë e popullit.

Në gojëdhënat për Skënderbeun është paraqitur madhështia, urtia, gjeturia, afërsia me masën e popullit, që ka pasur kurdoherë kryetrimi. Figura e Skënderbeut në atë kohë i ka frymëzuar parreshtur rilindësit poashtu do të ketë ndikuar edhe kujtimi, të cilin e ruajti populli për këtë figurë historike.

Pos mirëkuptimit që ka pasur A l b a n i a ndaj letërsisë popullore, ajo ka pasur edhe respekt ndaj mbledhësve të saj, duke botuar shënimet më të thjeshta rreth punës së tyre, qëndrimet e tyre rreth kësaj letërsie.

„Kam mbledhë do kangë gegnishte prej gjithkrah ka pak, e po i çoi Zotnies s'Atë për me i përdorue si t'duket ma mirë. I kam mbledhë si dalin prej gojës s'popullit, e prandaje mundet me gjikue ni rraje t'saket sado qi jo fort t'bukur, a ka populli i jone poezie a jo”.⁸ Kështu shkruante një atdhetar, një folklor-

⁸ Albania, nr. 8, 1903, f. 116.

dashës, i cili, duket se, pajtohej me Redaksinë dhe punën e saj që t'ua bëjë të njohur edhe të tjerëve këtë letërsi. Në këtë shënim ai sheh se është e nevojshme që dikush t'i hyjë vlerësimit të letërsisë popullore. Vërtet, kjo pjesë e letërsisë nuk i kishte studjuesit e saj.

Një qëndrim edhe më të qartë e paraqet vetë Redaksia:

„I shtrenjti miku e bashkëpunëtori jonë, Zoti Geg Postrippa pati një mendim shumë të mirë, duke nisur te „Albania“ këto këngë të vjetëra të popullit. U lutemi fort gjith atdhetarëve të na dërgojnë sa vjersha të tillë t'u — mundet. Le të mos kujtojë kush se kio mënyrë pune s'është e lartë: Vjershat e popullit kanë rëndësi të madhe për historinë, e sot për sot n'Europë dietar të vërtetë s'e kanë turp të shkojnë kohën e tyre duke mbledhur pralla edhe këngë të popullit. E thomi këtë, se e dimë që shumë Shqiptarëve u duket pun' e vogël e e palevdueshm të përpiqen për kësi shkrimesh”.⁹

Në këtë kohë popujt e Evropës, e, deridiku të Ballkanit, kishin arritur rezultate të mira në mbledhjen, botimin dhe afirmimin e letërsisë popullore në mjedise, ku ajo çmohej. Me anë të vlerave të letërsisë popullore, ata afirmomin prodhimin shpirtëror, mendor dhe filozofik të trashëgimisë popullore, dëshmonin identitetin kombëtar, ekzistencën e lashtë të kombit dhe pasurinë gjuhësore. Ishte koha kur secili popull përpiquej të ndërtojë me fakte fortesa, me anë të të cilave do të mbronte para botës ekzistencën e vet të kaluar dhe atë momentale si komb. Në këtë mënyrë ata mbroheshin nga sulmet dhe aspiratat e armiqve. Lëvizjet e tilla kombëtare përcilleshin me propagandë, me materie kulturele letrare, me të dhëna nga historia dhe tradita e popullit, luftëra, me arsimim, me anë të grumbullimit dhe të prezentimit të thesarit popullor etj. Këto manifestime të kohës ishin prezente në A l b a n i a , e cila idealet e tilla nuk i nxit nga t e k a , por nga nevoja që të kontribuojë. Mund të themi se një program të ngjashëm e kishin shkrimtarët, programin e aksioneve në kohën e Rilindjes, të cilin e shfaqnin në punimet letrare për të arritur efekt më të madh. Një angazhim i tillë poetik me domethënie strategjike është poezia e Luigj Gurakuqit, e cila apelonte kështu:

*S'na bije n'mend se anmiku i ndyt
Përmbi ne gjithnji prigjon,
Qi pa da ja mba ngul syt
Tokve tona qi lakmon;
E qi kqyrë me na shti n't'keq,
Me mujt, t'dam, me na zan' n'leq.¹⁰*

Programi i përgjithshëm i lëvizjes kombëtare i ngjante shumë asaj krijimtarie popullore që ishte shfaqur me shekuj, por as shkrimtarët e Rilindjes nuk u larguan shumë nga kjo rrugë e trasuar, me përjashtim se shtuan forcën e kësaj lëvizjeje dhe ndezën më tepër zemrat e atdhetarëve. Në këtë drejtim, detyrat e revistave dhe të shoqërive shqiptare jashtë vendit, ishin në tërësi detyrë patriotike. Të gjitha punimet ushtronin ndikim më të madh mu për hir se ishin të pranueshme, të kuptueshme, të afërta me masën e popullit.

⁹ *Albania*, nr. 1, 1900, f. 39.

¹⁰ F. Shiroka e L. Gurakuqi, *Vjersha të zgjedhura*, Prishtinë, 1963, f. 76.

Mund të pohohet me siguri se kjo këngë popullore ka për qëllim t'u tregojë dhe të ndezë gjakun e luftëtarëve për pavarësi, dhe, se ky ideal, në luftat e mëparshme, është realizuar pjesërisht, në disa treva me fitore:

*Malet t'ona zun e rënkojnë,
Kurveleshët po leftojnë,
Me pashanë ç'u — përpoqnë.
Dil e shifi Korçallitë,
Te kanë 'zënë gure zinë.
O pasha t'u — ngjat'jeta,
Pse kështu të dridhet miekra!
S'ke par' plumba nga Gjon-Leka?*¹¹

Redaksia e revistës e jep një vlerësim të këtyllë me rastin e botimit të disa këngëve të mbledhura nga Th. Mitko:

„Këto viersha të vogëla janë të vërtetë gurë të çmueshëm të letretyrës popullore s'onë. Me sa hollësi të shishme janë të thëna gjith' ato fjalë!” E janë të zgjedhura me një të tillë mënyre që viersha tingëllon në vesh me një ëmbëlsie të rrallë. Të mirën si shembëllime letretare”.¹²

Kur e kemi fjalën për këngët lirike që u botuan në *Albania*, duhet ta themi se motivi i kurbetit ka helmuar idilën e dashurisë qoftë të bashkëshortëve, qoftë të atyre që ende nuk janë bashkuar për të filluar jetën dhe, ka tronditur e çrregulluar familjet tona:

— *Kur je nisur të më vesh,
O beqar këmishezi?
— Se ç'jam nisur në kurbet,
Moj lili hanko Dudi,
Se ç'jam nisur në kurbet,
Moj lili gjysmë flori.*¹³

Këngët e dashurisë janë numerikisht më të pakta se këngët historike ose, veç figuracionit të pasur, mbajnë edhe tituj simbolikë, që përtrijnë dhe joshin veprimet e rinisë, siç janë: *Nerendza*, *Thellandza*, *Mollat*, *Lulezime* etj.

Ato, madje, janë këngë të thurura bukur:

*Po lulojshin pieshkat,
Po na vijn të zeshkat.
Po lulojshin dardhat,
Po na vijn të bardhat.
Po lulojshin kumbullat,
Po na vijn të rumbullat,
Po lulojshin mollat,
Po na vijn mes-hollat.*¹⁴

¹¹ *Albania*, nr. 10, 1901, f. 153.

¹² *Albania*, nr. 9, 1903, f. 143.

¹³ *Albania*, nga 15 gjer në 30 të marsit 1899, f. 38.

¹⁴ *Albania* nr. 9, 1903, f. 143.

Mbledhja dhe botimi i letërsisë popullore në Albania është bërë në mënyrë amatore, mungojnë shënimet elementare për letërsinë dhe subjektet. Si duket, fizionomia e anonimitetit të revistës ka ndikuar edhe në këtë pjesë të letërsisë. Por, qëllimi që të botohet kjo letërsi, të njihen të huajt me të dhe të ndihmojnë e të ndikojnë në zgjimin kombëtar, është i qartë dhe i drejtë.

Albania do të çmohet për përpjekjet që ka bërë për prezentimin dhe për popullarizimin e kësaj pjese të letërsisë tek ne dhe ndër të huajt. Letërsia popullore në këtë revistë gjeti mirëkuptim, u përkrah, dhe në këtë mënyrë ajo iu bashkua kulturës sonë në përgjithësi, në mënyrë të veçantë letërsisë sonë të shkruar, duke plotësuar të dyja së bashku zbrastësinë që ndihej në letërsi dhe duke forcuar në masat e gjera dashurinë për atdhe e për popull.

Rrustem Berisha

PRESENTATION ET BUT DE LA PUBLICATION DE LA LITTERATURE POPULAIRE DANS „ALBANIA”

Résumé

Sous un aspect général la revue „Albania ” présentait directement les problèmes de l'époque, qui pour les Albanais avaient un sens d'actualité. La Revue allait donc dans le sens des efforts du mouvement de Rilindja (Renaissance) et eut une activité importante dans les disciplines scientifiques d'albanologie. On a publié dans „Albania” plus de littérature populaire que dans n'importe quelle autre revue de l'époque. Les Albanais étaient encouragés à recueillir et à publier cette littérature populaire inconnue et non appréciée par eux-mêmes, ni par les étrangers.

On publiait la littérature populaire dans la revue principalement pour trois raisons: Premièrement—pour encourager davantage le recueillement et la publication de cette littérature. Deuxièmement — pour la rendre accessible aux étrangers qui pouvaient découvrir ses qualités littéraires par des traductions en langue française. Troisièmement — pour présenter la littérature populaire à la littérature écrite et l'engager dans le mouvement national.

Nous avons accentué le dernier but en mettant en relief son rôle durant cette période.

Nous avons cité l'activité simultanée de la littérature populaire et écrite, en signalant qu'elles étaient très proches l'une de l'autre en ce qui concerne leur but et l'architecture poétique.

On trouve dans „Albania” quelques notes abrégées sur la littérature populaire qui ont une importance particulière pour l'histoire du folklore de cette période reculée et qui étaient peu nombreuses pour cette époque.

On a publié dans cette revue plus de 150 chansons, fables, dictons, légendes. Ces notes pourraient constituer un ouvrage assez important à une époque où les ouvrages écrits ne suffisaient pas. Comme telle, la Revue est un monument modeste du folklore.

...dans les conditions de la loi de 1901 sur les associations
...de personnes physiques et morales, sans but lucratif
...et sans caractère d'administration publique, et qui
...ont pour objet l'exercice d'une activité d'intérêt
...général, d'utilité sociale ou de bienfaisance, et qui
...sont régies par les dispositions de la loi de 1901
...et de la loi de 1924 sur les sociétés civiles
...et commerciales, et de la loi de 1925 sur les
...sociétés de personnes.

...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes
...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes
...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes

PROJET DE LOI RELATIF A L'ORGANISATION DE LA JUSTICE

...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes
...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes

...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes
...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes
...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes

...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes
...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes
...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes

...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes
...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes
...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes

...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes
...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes
...et de la loi de 1925 sur les sociétés de personnes